


Rekomendacione

**Për Parandalimin dhe Menaxhimin e Dhunës Seksuale
Kundër Femrave Emigrante Punëtore Shtëpiake**



PROJECTI COMMUN-AID



Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare e Programit Daphne III të Bashkimit European. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm i autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Komisionit Evropian”.

PROJECTI COMMUN-AID

COMMUN-AID është një projekt i financuar nga Comisioni Evropian nën Programin Daphne III (JUST / 2011 / DAP / AG / 3272). Është realizuar në pesë shtete Evropiane (Greqi, Qipro, Austri, Suedi dhe Slloveni) me përfshirjen e ekspertëve nga Holanda. Projekti kishte për qëllim të rrisë kapacitetin e femrave emigrante punëtore shtëpiake për ti përgjigjur dhunës seksuale në punët shtëpiake përmes zhvillimit dhe testimit të intervenimeve të bazuara në komunitet.


Projekti COMMUN-AID kishte një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe realizoi të mëposhtmet:

1. Rritje të mirëkuptimit mbi përvojat e grave të viktimizuar seksual dhe identifikimi i nevojave të tyre në mbështetje të pas-viktimizimit përmes metodave rigorozë kërkimore cilësore dhe afrimit.
- 2.. Zhvillimi i një portofoli burimesh të komunitetit, aleatëve, ndërhyrjet dhe politikat për gratë e viktimizuar seksualisht emigrante duke përdorur një proces hartimi dhe një kërkim kualitativ me informuesit kyç në të gjitha shtetet partnere.

3. Të zhvillojë një mjet kulturor dhe gjuhësor të përshtatshëm në internet për mbështetjen e punëtoreve shtëpiake emigrante femra të viktimizuara seksualisht, që është i hapur për to Gjuhët emigrante (<http://www.domesticwork-ersupport.info/>).

4. Hartimi dhe krijimi i një programi pilot të provuar trajnimi për trajnerët me programe arsimore të komunitetit, që synon në zhvillimin e kapaciteteve në komunitete përmes trajnimit të anëtarëve të komunitetit mbi parandalimin dhe menaxhimin e viktimizimit seksual në punët shtëpiake.

5. Ndërgjegjësim i ngritur nga grupe përkatëse të interesit si krijuesit e politikave, shkencetarët, ofruesit e shërbimeve, punëtorët emigrantë shtëpiake dhe publiku i përgjithshëm mbi problemin e dhunës seksuale kundër punëtoreve shtëpiake emigrante femra përmes trajnimit në komunitet, konferencave rajonale, botimeve shkencore, gazetave dhe projektit dhe shtypja e njoftimeve si edhe aktivitete të tjera të shpërndarjes të informacioneve në shtetet partnere.



REKOMANDIME

Seti i rekomandimeve, që paraqitet brenda këtij dokumenti, përmbledh njohuritë e fituara nga projekti COMMUN-AID dhe ka për qëllim të mbështesë hartuesit e politikave, punëtorët e komunitetit, ofruesit e shërbimeve dhe profesionistët e shëndetit në parandalimin dhe menaxhimin e dhunës seksuale ndaj punëtorëve emigrantë shtëpiak. Rekomandimet akoma kanë për qëllim të ofrojnë një bazë të përbashkët njohurie dhe kuptimi në lidhje me dhunën seksuale ndaj femrave emigrante punëtore shtëpiake, si dhe ndihmë për planifikimin dhe zbatimin e përmirësimeve në praktikën profesionale

Rekomandimet janë formuluar në bazë të detyrave bashkëpunuese të mëposhtme që janë kryer si pjesë e projektit COMMUN-AID:

- (a) Një kërkim kualitativ me 66 femra të viktimizuara emigrante punëtore shtëpiake nga Austria (n=15), Qipro (n=16), Greqi (n=20) dhe Suedi (n=15); (b) Një shikim sistematik e literaturës (elektronike dhe të shkruar), nga pesë baza të dhënave shkencore (PUBMED, SCOPUS, WEB OF SCI-ENCE, EBSCO dhe HEIN-ONLINE) mbi dhunën seksuale e investiguar kundër femrave emigrante punëtore shtëpiake në këtë kërkim si dhe në azhëndën politike të Evropës;
- (c) Një kërkim kualitativ me 55 informatorë kyç nga

shtetet palë (AU, CY, GR, SE, SL) që përfaqësojnë sektore të ndryshme si më poshtë: organizata qeveritare/autoritete publike (n=21), sindikata (n=2), organizata të punëdhënësve (n=1), korporata private (n=3), organizata jo-qeveritare (n=25), grup komunitar (n=1), dhe të tjera (n=2); (d) Një proces hartimi i burimeve komunitare, aleatëve, politikave dhe ndërhyrje që bëhen nga shtetet partnere (AU, CY, GR, SE, SL);

(e) Një program trajno-trajnerin, i projektuar në bazën e rezultateve të kërkimeve të COMMUN-AID me qëllim arsimin e komunitetit dhe testimin në bazë pilotike me 10 pjesëtarë të komunitetit në çdo shtet partner (AU, CY, GR, SE, SL)

Rekomandimet janë të organizuara në katër tema specifike të ndërhyrjeve përkatëse në:

- Procedurat rregullatore dhe legjislativë të punës.
- Procedurat strukturore dhe institucionale.
- Fuqizimi i grave emigrante dhe ndryshime në perceptimet publike të punëtorëve emigrante shtëpiake.
- Rritje kërkimore dhe përmirësim i të dhënave të mbledhura

Rekomandimet do të shpërndahen para palëve të interesuara relevante që merren me parandalimin dhe menaxhimin e dhunës seksuale kundër femrave emigrante te shtetet partnere në nivel Evropian

Domestic Workers: A Growing Workforce




Domestic workers worldwide

If all domestic workers worked in one country...



that country would be the 10th largest employer in the world.



of domestic workers are women



1 in every 13 female wage earners is a domestic worker

Source: International Labour Organization, 2013

Tracy Loeffelholz Dunn

Fuqizimi i Femrave Emigrante Punëtore Shtëpiake

Rekomandimet e mëposhtme synojnë të përmirësojnë kapacitetet dhe aftësitë e femrave emigrante punëtore shtëpiake në lidhje me dhunën seksuale

Rekomandimi #1

Femrat emigrante punëtore shtëpiake duhet të kenë mundësinë të zhvillojnë aftësitë personale në trajtimin e dhunës seksuale, përmes programeve të trajnimit.

Rekomandimi #2

Femrat emigrante punëtore shtëpiake, të cilat janë punësuar pranë agjencie të rekrutimit, duhet të marrin pjesë në programe të gjithanshme në vendin e origjinës ose të destinacionit.

Çfarë dimë

Projekti COMMUN-AID ka gjetur se shumë prej femrave emigrante punëtore shtëpiake që janë viktimizuar seksualisht:

- Nuk kishin informacion mbi të drejtat e tyre dhe burimet e mbështetjes formale dhe joformale..
- Nuk kishin njohuri mbi hapat e duhura të raportimit

Projekti COMMUN-AID ka gjetur se shumë prej femrave emigrante punëtore shtëpiake që janë viktimizuar seksualisht:

- Nuk kishin udhëzime në lidhje me të drejtat dhe obligimet e tyre.
- Nuk kishin udhëzime në lidhje me kërkimin e një pune të sigurt.
- Nuk kishin udhëzime për të fituar aftësi të mira për punë.





Çfarë dimë

Projekti COMMUN-AID ka gjetur se shumë prej femrave emigrante punëtore shtëpiake që janë viktimizuar seksualisht:

- Nuk kishin informacion mbi të drejtat e tyre dhe burimet e mbështetjes formale dhe joformale.
- Nuk kishin njohuri mbi hapat e duhura të raportimit
- Nuk kishin udhëzime në lidhje me të drejtat dhe obligimet e tyre.
- Nuk kishin udhëzime në lidhje me kërkimin e një pune të sigurt.
- Nuk kishin udhëzime për të fituar aftësi të mira për punë.
- Nuk kishin mbështetje në raportimin e viktimizimit të tyre.

Mbështetje Formale në vijim të Dhunës Seksuale

Rekomandimet e mëposhtme përqendrohen në mbështetjen qeveritare dhe jo-qeveritare ose kujdesin e ofruar për viktimat e dhunës seksuale në shtetin e punës shtëpiake si dhe ka qëllim të përmirësojë cilësinë e ofrimit të shërbimeve përmes rritjes së kapacitetit të përgjithshëm të shërbimeve ekzistuese për t'u marrë me popullësinë e punëtorëve shtëpiake emigrant si dhe përmes presantimit të aksesit dhe procedurave miqësore për emigrantët. Këto rekomandime pritet të përmirësojnë cilësinë e kontaktit të viktimave të femrave emigrantëve në shërbimet dhe rritjen e nivelit të raportimit të viktimizimit edhe kërkimin e mbështetjes profesionale.

Rekomandimi #1

Shërbime të përshtatura duhet të zhvillohen me misionin e ndalimit të dhunës seksuale kundër punëtorëve shtëpiake dhe të iniciojnë veprime që synon parandalimin e problemit.

Rekomandimi #2

Shërbimet ekzistuese që adresojnë dhunën me bazë gjinore duhet të zgjasin misionin e tyre dhe të zhvillojnë kapacitete në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale ndaj punëtorëve shtëpiake.

Rekomandimi #3

Protokolle bashkëpunimi duhet të zhvillohen dhe të bëhen të njohura përmes shërbimeve që ofrohen për mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale në punët shtëpiake në sektorët qeveritarë dhe jo-qeveritarë, duke përfshirë OQ, OJQ-të, grupet e kishës dhe të komunitetit, për të siguruar standarde uniforme të kujdesit dhe vazhdimësinë e kujdesit për femrat emigrante që kanë rënë viktimat të dhunës seksuale në punë shtëpiake.

Rekomandimi #4

Interpretuesit dhe / ose ndërmjetësit kulturorë duhet të jenë në dispozicion të shërbimeve që janë në kontakt me femrat punëtore shtëpiake emigrante të viktimizuar seksualisht.

Rekomandimi #5

Trajnimi kulturor duhet të ofrohet nga profesionistët të vijës së parë të cilët mbështesin femrat emigrante punëtore shtëpiake që janë viktimizuar seksualisht.

Rekomandimi #6

Informacione të përkthyer dhe të përshtatshme nga ana kulturore duhet të jenë në dispozicion të shërbimeve që ofrojnë ndihmë profesionale për emigrantet femra, viktimizuar seksualisht në punët shtëpiake.

Çfarë dimë

Projekti COMMUN-AID ka gjetur se shumë prej femrave emigrante punëtore shtëpiake që janë viktimizuar seksualisht, pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor:

- Ishin të punësuar në mënyrë të parregullt, me "marrëdhënie atipike", që nuk i ndjekin dispozitat e ligjit në aspektin e pagesës dhe sigurimeve shoqërore.
- Kanë punuar si punëtore shtëpiake për shkak të mungesës së aftësive gjuhësore, nivelit të ulët arsimor dhe mungesës të kualifikimeve, si dhe për shkak të statusit të padokumentuar, të cilat nuk lejojnë punësimin zyrtar në një pozicion që korrespondon me kualifikimin e tyre.

Projekti COMMUN-AID ka gjetur dhe se:

Në disa shtete, legjislacioni për ngacmimin seksual në shtetin e punës shënjestron vetëm ngacmime brenda organizatës, dmth dhunë nga menaxherët apo në mes të të punëtorëve. Legjislacioni nuk zbatohet për personat e vetëpunësuar.

Rregullatore Pune dhe Legjislacioni

Rekomandimet e mëposhtme kanë për qëllim të përmirësojë kushtet e punës rreth punëve shtëpiake duke pranuar atributet e veçanta që karakterizojnë mjedisin e punës në sektorin e punësimit shtëpiak.

Rekomandimi #1

Ratifikimi i menjëhershëm dhe transpozimi i instrumenteve të mëposhtme: Konventa ILO 189.

Konventa CoE mbi VAW.

Direktiva EC për vendosjen e standardeve minimale për mbrojtjen e viktimave të krimeve.

Rekomandimi #2

Është e rëndësishme Ministria e Punës dhe Kodet e Punës të marrin përgjegjësinë e rregullimit të punëtorëve shtëpiak në shtetet ku rregullimi në këtë sektor të punës është i parashikuar nga Ministritë e Punëve të Brendshme dhe Ligjeve të Emigracionit.

Rekomandimi #3

Politikat dhe masat që adresojnë dhunën kundër punëtorëve shtëpiak duhet të jenë të pavarura nga statusi i qëndrimit dhe mekanizmat e menaxhimit të emigracionit.

Rekomandimi #4

Aksesi tek drejtësia dhe mbrojtja, në mënyrë specifike aksesi në strehim, duhet të vihen në dispozicion dhe të garantohen nga politikat përkatëse kombëtare, pavarësisht nga statusi i punësimit dhe i vendbanimit.

Rekomandimi #5

Të gjitha rregulloret dhe politikat në dispozicion për llojet e tjera të punësimit, duhet të shtrihen dhe në punët shtëpiake. Inspektimi i Punës duhet të ketë akses në të dhe duhet të kryej inspektime të rregullta në vendin e punës të punëtorëve shtëpiak, dmth në shtëpi private.

Rekomandimi #6

Vlerësimi i punëdhënësve/it të punëtorëve në punët shtëpiake duhet të kryhet me përfundimin e kontratës, nën mbikëqyrjen e agjencive të akredituara të punësimit. Akses nën mbikëqyrje në format e vlerësimit duhet të lejohet për të gjithë njerëzit që kërkojnë të punojnë në punë shtëpiake.

Rekomandimi #7

Mekanizma monitorimi formale / qeveritare të duhet të krijohen për të siguruar që agjencitë e punësimit të respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe nëqoftëse puna shtëpiake është kryer në pajtim me ligjet e punës, rregulloret ose marrëveshjet kolektive mbi punësimin.



Ndërgjegjësimi publik

Rekomandimet e mëposhtme kanë për qëllim të nxjerrin në shesh nevojën e rritjes të ndërgjegjësit të grupeve të ndryshme si një mjet që të rrisin njohuritë e të drejtave të njeriut dhe reduktimin e diskriminimit në bazë të punësimit dhe përkatësisë etnike.

Rekomandimi #1

Duhet të merren masa për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në përgjithësi mbi fenomenin e dhunës seksuale ndaj femrave emigrante punëtore shtëpiake.

Rekomandimi #2

Fushatat duhet të organizohen, me qëllim sensibilizimin e zyrtarëve publik, në veçanti policisë dhe profesionistëve të shëndetit, mbi diskriminimin dhe dhunën që përballojnë punëtorët shtëpiake.

Rekomandimi #3

Fushatat sensibilizuese publike duhet të organizohen me qëllim luftimin e perceptimeve të gabuara gjinore dhe raciale që ekzistojnë në përgjithësi midis njerëzve si dhe mitet e punës shtëpiake.

Rekomandimi #4

Duhet të merren masa për të ndryshuar mënyrën që punëtorët shtëpiake dhe dhuna seksuale prezantohet në media.

Kërkimi dhe Monitorimi

Rekomandimet e mëposhtme përqëndrohen në kërkesat e grumbullimit të dhënave dhe qëllojnë në forcimin e njohurive bazë mbi dhunën seksuale ndaj punëtorëve emigrantë shtëpiake përmes kërkimeve rigoroze dhe monitorimin efikas të problemit.

Rekomandimi #1

Të dhënat koherente dhe të krahasueshme në shkallë aktuale të dhunës seksuale ndaj femrave emigrante punëtore shtëpiake duhet të mbledhen përmes prezantimi të indikatorëve të pranuar gjerësisht.

Rekomandimi #2

Studimi mbi vlerësimin e dhunës seksuale ndaj punëtorëve shtëpiake duhet të stimulohet në nivel Evropian, për të siguruar matjen dhe monitorimin e problemit në të gjithë Evropën.

Çfarë dimë

Projekti COMMUN-AID gjeti se:

- Dhuna seksuale kundër femrave emigrante punëtore shtëpiake nuk gjën mbështetje nga policia.
- Shumica dërmuese e femrave emigrante punëtore shtëpiake të viktimizuara seksualisht nuk ndihet e sigurt të raportojë incidentet e dhunës seksuale para autoriteteve lokale.
- Shumë femra emigrante punëtore shtëpiake të viktimizuar seksualisht besonin se ata nuk do të besonin dhe / ose rasti i tyre nuk do të merret seriozisht për shkak se nuk ka pasur dëshmitarë ose sepse ato janë emigrante.
- Dëshmitë e botuara mbi dhunën seksuale ndaj femrave emigrante punëtore shtëpiake nga rajoni i Evropës janë të pakta. Nuk ka informacion të mjaftueshëm dhe statistika në dispozicion mbi problemin dhe kjo e bën të vështirë strategjitë e ndërhyrjes
- Shumica e femrave emigrante punëtore shtëpiake të viktimizuara seksualisht kanë vuajtur:
 - Depresion dhe simptoma psikosomatike.

- Nivele të larta stresi.
- Vështirësi ekonomike për shkak të papunësisë së tyre.
- Ndjenja negative për burrat.
- Mosbesim ndaj njerëzve.

Një rishikim sistematik e literaturës në pesë bazat e të dhënave; PUBMED, SCOPUS, WEB OF SCIENCE, EBSCO dhe HEIN-ONLINE si dhe në 20 revista të shqyrtuara udhëheqëse shkencore në fushat e "Ligjit", "Shkencave Sociale" dhe "Shëndetit", të lëshuara në gjuhë amtare, rezultoi në 26 nene potencialisht relevante me dhunën seksuale ndaj punëtorit emigrant shtëpiake. Totalisht 12 artikuj nga 26 plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Botuar midis 2003 dhe 2013
- Përcaktimit Evropian.
- Në gjuhët Greqisht, Gjermanisht, Suedisht, Sllovenisht dhe Anglisht.
- Përbëjnë një abstrakt.
- Përqëndrohen te "Punëtorët shtëpiake emigrant dhe dhuna seksuale

PARTNERJI PROJEKTA COMMUNAID



TECHNOLOGICAL
EDUCATIONAL
INSTITUTE OF CRETE



THE LABORATORY OF HEALTH AND



INFORMACIONE KONTAKTI:

Laboratori i Shëndetit dhe Sigurisë Rugore, Departamenti i Punës Sociale

Instituti Teknologjik Arsimit i Kretës, Greqi

Adresa: Rruga Estavromenos, Iraklion Cretë, P.C. 71004, Greqi

Telefon: +30 (2810) 379516, +30 (2810) 379514, E-mail: daphne@staff.teicrete.gr

Website: www.teicrete.gr/CommunAid/

Visit our website at:

[www.teicrete.gr/
CommunAid/](http://www.teicrete.gr/CommunAid/)



“ Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Programit Daphne III të Bashkimit Evropian. Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Komisionit Evropian